

Eppc kërkon një **Brand Manager** për klientin e saj, një ndër shoqëritë lider në fushën e importit dhe distribucionit në Shqipëri.

Përgjegjësitë Kryesore:

- Zbaton planet e marketingut për markën duke gjetur mënyra specifike pozicionimi në treg me qëllim përmirësimin e prezencës dhe vizibilitetit të markës;
- Sigurohet që të gjitha aspektet e marketingut dhe aktiviteteve të produktit të përputhen me etikën dhe qëllimet e markës;
- Identifikon, vlerëson dhe plotëson nevojat e klientëve bazuar në politikën dhe strategjinë fitimprurëse dhe komerciale të kompanisë;
- Menaxhon dhe promovon zhvillimin e produkteve/markave të reja në bashkëpunim me departamentet e tjerë të kompanisë;
- Vendos dhe zhvillon marrëdhënie të qëndrueshme midis kompanisë dhe klientëve;
- Planifikon dhe zhvillon masa konkrete për realizimin dhe tejkalimin e objektivave.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare në Ekonomi, dega menaxhim biznes, preferohet profili Marketing;
- **Minimum 2 vite eksperiencë pune në pozicionin Brand Marketing;**
- Të zotërojë shumë mirë gjuhën Angleze dhe Italiane, të folur dhe të shkruar;
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi, analitike dhe menaxhuese;
- Të zotërojë patentë të klasit B.

Të dhënat:

Pozicioni:	Brand Manager;
Vendndodhja:	Tiranë;
Pagesa:	Shumë e mirë ;
Kontrata:	Sipas Kodit të Punës;
Aplikimet mbyllen:	10.01.2018

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke **përmendur pozicionin për të cilin aplikoni** në adresën e e-mail^{it}:

recruitments@eppc.al

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen.
Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.